



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1313/3prot.

Datë 11.07.2023

V E N D I M
Nr. 592/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.07.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-70915-05-30-2023, me objekt “Sistem i menaxhuar i printimit (SMP)” me fond limit 5,870,000 (pesë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol Sh.A.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Modifikimin e dokumenteve të procedurës të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Ankimues: “Infosoft Office” SHPK
Kodër Kashar, Autostrada Tiranë Durrës km8, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Albpetrol Sh.A.
Lagja “29 Marsi” Patos, Selia Rruga Fier – Patos, km 7

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesa e operatorit ekonomik wshtw paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 01.06.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit me “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-70915-05-30-2023, me objekt

“Sistem i menaxhuar i printimit (SMP)” me fond limit 5,870,000 (pesë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol Sh.A

II.2. Në datën 07.06.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3167 dhe me nr. 1313/2023 protokollin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit.

II.2.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.2.2. Nëpërmjet shkresës nr.3208/7 prot., datë 13.06.2023, protokolluar me tonën me nr.1313/2 prot., datë 19.06.2023 me objekt “Dërgohet vendimi lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” ShPK për procedurën e prokurimit me objekt “Sistem i menaxhuar i printimit (SMP)” me nr. REF-70915-05-30-2023 ”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.2.3. Referuar shkresës së sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” ShPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pjesërisht pranimin e ankesës si më poshtë: “[...] Lidhur me pretendimet e ngritura ne ankese, KSHA arsyeton si me poshte:

• Për kërkesën e pare, per pretendimin ne lidhje me kriterin e vendosur nga AK:

Tek shtojca 8, kriteret e pergjithshme te perzjedhjes/kualifikimit, pika 2.3.2 AK ka kerkuar:

Operatori ekonomik duhet te jete distributor zyrtar per territorin e Republikes se Shiperise per marken e pajisjes ge posedon/ ose te jete i paisur me autorizimin nga distributori zyrtar vendas per kryerjen e sherbimit objekt prokurimi. Ne rastin e autorizimit nga distributore zyrtar vendas, duhet te paragitet lidhja midis prodhuesit he distributorit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme per ak ne rast verifikimi nga ana e tij.

KSHA, i ngritur nga AK me urdhrin nr. 3208/4, date 08.06.2023, "Për pezullimin e procedurave dheshqyrtimin e ankeses per tenderin me objekt: "Sistem i Menaxhuart i Printimit (SMP)», me REF-70915-05-30-2023, e merr ne konsiderate kerkesen e OE Infosoft Office.

Per sa me siper, pretendimi i ankuesit per kerkesen e pare, qendron.

Per kerkesen e dyte, per pretendimin ne lidhje me modifikimin e kriterit te vendosur nga AK:

Tek shtojca 8, kriteret e pergjithshme te perzjedhjes/kualifikimit, pika 2.3.4 kerkohet qe:

Operatori ekonomik duhet te kete te punësuar staf teknik te pakten 2 (dy) punonjese te certifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose distributori i autorizuar pwr mirembajtjen e pajisjeve qw oferton, ose certifikuar nga institucionet e autorizuar te akredituara nga dpa ose nga organizma ndwrkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqipwrise.

• KSHA, konstaton se OE Infosoft Office kerkon qe ky kriter te modifikohet si me poshte:

“Operatori ekonomik duhet te kete te punësuar staf teknik te pakten 2 inxhinier (Elektronik/, Mekanik/IT/Mekatronik ose Teknik te certifikuar nga institucionet e autorizuar te akredituara nga DPA ose nga Organizma ndwrkombwtare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqipwriose”

Persa i përket kerkeses për modifikim nga ana e OE, si me siper, KSHA gjykon se kjo kerkese eshte ne kundërshtim te plotw me vendimin nr. 6/2023, date 06.01.2023, te KPP, pika III.1.8 ku përcaktohet se:

**..ne lidhje me pretendimet per ndryshimin e kriterit:*

OE duhet te kete jo me pak se 5 punonjws ne liste pagese nga te cilwt 3 nga keta punonjes te jene teknike elektronike te pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik te lwshuar nga organet perkatese. Per keta punonjes duhet te paragiten deshmitë perkatese de duhet qe te figuronjnw liste pagesat e 3 muajve te fundit, gjykon, se kriteri i vendosur nuk eshte ne perpjesëtim dhe i lidhur ngushte me objektin e kontrates, pasi autoriteti kontraktor ne rastin konkret ku objekt wshtw “Shwr bim printimi” e rendesishme eshtë kryerja e shërbimit. Ne këtë kontekst kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor jo me pak se 5 punonjws ne liste pagese, nga te cilët 3 punonjës te jene te diplomuar si inxhinier Elektronik/mekatronik ose IT eshte njw kriter i cili e kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike ne nje procedure prokurimi si dhe ul konkurrencen, dhe jo ne proporcion me objektin e kesaj procedure prokurimi, nuk wshtw e nevojshme nje ekspertize e tille, pasi dhe punonjes me kualifikime te ndryshme mund te kryejne te njejtën detyre, ndaj autoriteti kontraktor duhet te modifikojë kriterin e ne funksion te hapjes se konkurrences ndërmjet operatoreve ekonomike duke mos kufizuar ate me togfjalwshin “Inxhinier”. Pra, nisur nga arsytimi i KPP ne vendimin nr. 6/2023, date 06.01.2023, pika III. 1.8, perdorimi i togfjalëshit “inxhinier” si pjese e kriterit do ishte ne dem te hapjes së konkurrences dhe biznesit tw vogël dhe te mesëm, pasi vendosja e stafit te diplomuar “Inxhinier” do te pengonte se pari bizneset e vogla e e mesme, tw cilat mund te kene staf teknik, por jo te diplomuar si “Inxhinier”. KSHA konstaton se togfjalëshin “Teknik tw certifikuar nga institucionet e autorizuar nga DPA ose nga Organizma nderkombwtare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise” Autoriteti Kontraktor e ka përfshire ne kriterin 2.3.4, “Operatori ekonomik duhet te ketw te punësuar staf teknik te pakten 2 (dy) punonjws te certifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose distributori i autorizuar per mirëmbajtjen e pajisjeve qw oferton, ose certifikuar nga institucionet e autorizuar te akredituara nga DPA ose nga Organizma Nderkombwtare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqipwriose”

• KSHA vlerëson se Sistemi i Menaxhuar i Printimit, objekt i këtij prokurimi do te realizohet me 50 pajisje te cilat do te sillen nga OE fitues. Ne kwte kriter eshte kerkuar nga OE që, per ves implementimit te pajisjeve, do te mirwmbajne, riparojne, furnizojne me pjese konsumi pajisjet qe do tw perdoren ne kwte proces. Qe te realizohet shërbimi i kerkuar, i gjithë sistemi duhet te monitorohet dhe te gjitha pajisjet te jene ne gjwndje pune 100% te kohës. Eshte minimum dhe thelbësore per mirëfunktionimin e te gjithë procesit nevoja e specialistwve te trajnuar për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Defektet jane te pashmangshme de kwtu lind nevoja e nje specialisti te trajnuar për mirembajtjen dhe riparimin e tyre.

• KSHA gjykon se, nisur nga volumi i kontratws, kriteri ku kerkohet qw OE te kete minimalisht dy punonjes te certifikuar per mirëmbajtjen e pajisjeve eshte ne proporcion te drejte me volumin dhe natyren e kontratës.

KSHA gjykon se, ky kriter është vendosur për të hapur procedurën ku të marrin pjesë biznese të vogla dhe të mesme të cilat nuk mund të sigurojnë një certifikatë trainimi për pajisjet që posedojnë ngaproduhësi i pajisjes për që ka mundësi të sigurojnë nëpërmjet organizmave të akredituar apo subjekteve të licencuara.

KSHA vlerëson se, AK është në të drejtën e tij të sigurohet për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE, të cilat, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, ekonomike, makinerite, pajisjet he asetet e tjera fizike, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

• KSHA vlerëson se ky kriter është vendosur në harmoni të plotë dhe i mbështetur dhe nga vendimi i KPP Nr. 1280/2022, datë 22.12.2022, pikë III.2.8, e arsyetimit, ku shprehet se: Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Autoriteti Kontraktore në hartimin e kriterëve dhe /ose specifikimet teknike, krahas përshkrimit të saktë të kësaj të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i tyre duhet të bëhet në mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm dhe të hapur nëpërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmeri të kontratës. KPP thekson se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë OE pjesëmarrës në procedurat e Prokurimit Publik. Kriteret e vendosura dhe/ose specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengësive të pa justifikueshme për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimet teknike AK duhet të shmangin do forme diskriminimi goftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast kriteret dhe/ose specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbimi që ofrohet nga një operator i vetëm ekonomik.

..akoma më tej AK është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësia e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. RPP vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë AK për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE të cilat nëpërmjet dokumenteve të paraqitura duhet të vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet dhe asetet e tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës është në të drejtën e AK të përcaktojë kriteret për kualifikim në përputhje me dispozitat ligjore kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit.

Komisioni vlerëson se bazuar në kompleksitetin dhe vëllimin e kontratës objekt prokurimi, kërkesa për disponimin e një inxhinieri të certifikuar nuk është kërkesë e ekzagjruar por e certifikuar nga prodhuesi është kërkesë kufizuese dhe me synim përfitjen e konkurrencës dhe sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit prandaj AK duhet të marrë masa për modifikimin e kësaj kriteri duke vendosur dhe të ofrojë certifikime dhe ekuivalente.

• KSHA konstaton se kriterin “Për të pasur staf teknik të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve” Komisioni i Prokurimit Publik e ka mbështetur dhe me vendimin nr.06/2023, datë

06.01.2023, pika III.3.3 ku shprehet Komisioni konsideron kriter minimal te cilat nuk do te rendonin pozitat e operatoreve ekonomik pjesmarres ne kqto procedure.”

KSHA vlerwson se AK ka patur parasysh qw punonjësit e certifikuar për mirembajtjen e pajisjes qw posedone te jenw jo vetwm nga prodhuesi i pajisjeve por dhe nga Distributore te Autorizuar (me te drejtën per te dhene certifikata trajnimi) apo dhe nga institucionet e autorizuara te akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombetare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqipwriose.

Per sa me siper, pretendimi i ankuesit per kerkesën e dyte, nuk qëndron.

- Për kerkesen e trete, per pretendimin n° lidhje me specifikimet e pajisjeve, te vendosura nga AK: a. Nje specifikim jashte listes se AKSHI-t, eshte: “”ekrani jo me i vogel se 8 inch”.

- KSHA vlerëson se ne lidhje me diapazonin e ekranit AK, mbeshtetur dhe ne vendime te meparshme te KPP (vendimi 970/2021, date 07.12.2021) ka pasur ne konsiderate që diapazoni i ekranit te kenç nje madhesi mesatare (jo me te vogël se 8 inch), kriter ky jo diskriminues ne vendosjen e specifikimeve teknike, pasi nuk @shte diapazoni me i madh i ekranit. Te gjitha brandet e pajisjeve, te paktën te 3 viteve te fundit, per shkak te teknologjise se re (e cila ka prekur dhe kete fushete pajisjeve te IT), jane te pajisura me ekran deri ne 10.1 inch, tek te gjitha formatet e pajisjeve, si për formatet A4, po ashtu dhe tek formatet A3/A4. Sa me siper, AK ka zgjedhur diapazon mesatar te ekranit si kriter minimal (8 inch), pa penguar ge pajisjet te vijne dhe me ekran 8.5; 9; 9.5 apo 10.1. Na teknologjine e re te viteve tw fundit tw pajisjeve te printimit, ekрани nuk ka me vetem nje rol informues ku shfaqen vetem komandat e leximit (print/copy; ready or not) por te gjitha komandat e pajisjes, perfshi komandat e numrave, ikonat e ndryshme të funksionit te pajisjes deri tek ikonat e teknologjise se re, te cilat, sipas AK nuk mund te vendosen to gjitha ne nje ekran 4.3 inch (aplication site, conection, copy, print, scan, user guide, user tools, web browse, quick user, quick card, quick scanner, quick print, print/scan (memory storage device) apo te githe informacionin mbi funksionalitetin e parisjes mbi perdorimin e saj apo dhe statusin e saj ne kohe reale. AK ne vendosien e Ketin kriteri ka patur parasysh faktin se komandat ne rast fotokopjimi te dokumenteve nuk mund te funksionone ne nje ekran me prekje ne madhësine 4.3 inch ku duhet te shfagen te gjithë numrat, si dhe do te cenonte rendw funksionalitetin e pajisjes.

Teknologjia e re ne ditet e sotme nuk eshte komoditet, por wshte nevojë e perditshme per te na sherbyer dhe lehtësuar ndjeshëm ne punt e perditshme te nje punonjwsi apo te institucionit/kompanise ne ditwt e sotme.

- KSHA vlerwson se AK ka arsye te qenësishme per te ofruar kqte teknologji, e cila ofrohet nga te gjitha kompanite dhe brandet ne treg, per te krijuar kushte optimale per punonjwsi e vet ne përdorimin e saj dhe duke ekonomizuar kohën ne përdorimin e pajisjeve.

KSHA vlerwson se AK nw vendosjen e specifikimeve pwr pajisiet qw do tw ofrohen nga OE per sistemin e menaxhimit te printimit ka patur parasysh perfshirjen e te gjithë operatoret ne treg si dhe te gjitha brandet e pajisjeve.

- KSHA konstaton se OE Infosoft Office kerkon se njw seri specifikimesh qw jane vendosur tek pajisjet qe do te merren ne perdorim nga AK kanë shmangie nga vendimit nr 673, dt. 22.11.2017” standardet dhe jane ne kundertshim me standartet TIK te miratuara nga AKSHI, sipas vendimit 673 dt.22.11.2017.

Sipas pikes nenit 6, pika j, te VKM nr. 673, dt. 22. 11.2017, AKSHI Jep mendim per institucionet e tjera te administrates publike, me kerkese te tyre, per: - specifikimet teknike te prokurimeve, qw do të realizohen me fonde tw buxhetit tw shtetit, hua dhe/ose grante te dhwna nga donatore,

- KSHA vlereson se procedura e prokurimit ka objekt "Sistemi i menaxhimit te printimit" per nevojat e shoqwrsw "Albpetrol" sha, dhe pajisjet nuk do te blihen por do te vihen ne perdorim ose me qira nga operatorët ekonomike.

Qëllimi i VKM nr 673, dt. 22.11.2017, eshte sugjerimi per blerjet per pajisjet TIK, me specifikime minimale, që do te blihen nga institucione publike, te cilat kanë pasur veshitësi për nxjerrjen e specikimeve minimale he te cmimeve te tyre per blerje per perlllogaritjen e fondit limit.

Per kwtw AKSHI, sipas specifikime te paraqitura, ka ndertuar dhe tabelën udhëzuese me listen e çmimeve te blerjeve, te cilat institucionet publike mund tu referohen per blerjen e tyre.

Por AKSHI nuk ndalon qe te blihen pajisje me performance me te larte dhe te perditësuar me teknologjine e ditws (dhe aq me tepër pajisje te cilat do te merren me qira ose ne perdorim) nga ana e AK, pwr te patur garanci ne realizimin me sukses te kontrates dhe per lehtesi ne funksionalitet dhe ne përdorim.

Per sa me siper, pretendimi i ankuesit për kërkesën e trete, lidhur me specifikimin e pajisjeve me "ekrani jo me i vogël se 8 inch", nuk qëndron.

- Pwr kerkesen e trete, per pretendimin ne lidhje me specifikimet e pajisjeve, te vendosura nga AK:

b. skanimi nepermjet SD CARD.

- KSHA konstaton se OE Infosoft Office nuk eshte dakord me specifikimin teknik ge skanimi te kryhet dhe me SD card pasi, sipas OE, kwte specifikim e përmbush vetëm njw marke e caktuar pajisjesh ose nje numer shume i kufizuar pajisjesh.

- KSHA konstaton se Vendimi nr. 970/2021, i Komisionit te Prokurimit Publik, date 7.12.2021, pika III.2.6 e arsyetimit, percakton se. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se per realizimin e sherbimit te skanimit mund te pwrdoen disa alternativa sic eshte percaktuar ne specifikimet teknike, gjithashtu autoriteti kontraktor mund të vendose dhe variantin e perdorimit te adaptorit, i cili mund te kryeje shwrbimin e kwrkuar per pajisjet per printim/fotokopjim/skaner, duke mundwsuar perdorimin e SD CARD-it.

KSHA, mbwshtetur ne vendimin nr. 970/2021 te KPP, date 7. 12.2021, vendos ta pranoje pretendimin e OE Inforsoft Office dhe te modifikojw specifikimin ne kriterin e vendosur, si me poshte ndryshoje:

Ishte:

Skanimi: SPDF-single pas document

Full Network color Scan (Scan to e-mail,

feeder (skanimi i njehershem te dy aneve scan to folder, Scan to USB, SD CARD) te letres)

Behet:

Skanimi: SPDF-single pas document Full Network color Scan (Scan to e-mail, feeder (skanimi i njehershem te dy aneve scan to folder, Scan to USB, SD CARD) te letres)

skanimi me SD CARD te kryhet dhe me adaptor

Për sa me sipër, pretendimi i ankuesit per kërkesën e trete, lidhur me specifikimin e pajisjeve "skanimi nepermjet SD CARD", qendron.

Pwr kwto arsye:

Bazuar ne nenin 114 te ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 102 te vendimit nr. 285, te Keshillit te Ministrave, date 19.05.2021, "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", KSHA.

VENDOSI:

1. Te pranojw pjeserisht ankesen e paraqitur nga OE Infosoft Office, pwrkatësisht:

a. Te pranoje ankesen ne lidhje me heqjen e kriterit 2.3.2, ne shtojcën 8, "Kriteret e Pergjithshme te Perzjedhjes/Kualifikimit",

b. Te mos pranoje ankesen ne lidhje me modifikimin e kriterit pika 2.3.4, në shtojcën 8, "Kriteret e Pergjithshme te Perzjedhjes/Kualifikimit";

c. Te mos pranoje ankesen ne lidhje me modifikimin e kriterit "specifikimi i pajisieve - "ekrani jo me i vogël se 8 inch";

d. Te pranojw ankesen ne lidhje me modifikimin e kriterit "specifikimi i pajisjeve - "skanimi nepermjet SD CARD», sipas arsytimit ne kete vendim.*

2. Ky vendim i komunikohet Titullarit te AK, shogëria "Albpetrol" sh.a.

3. Kopje e këtij vendimi i njoftohet OE ankimues dhe Komisionit te Prokurimit Publik.

[....].

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues "Infosoft Office" shpk dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pjesërisht pranimin e ankesës si më poshtë: "[...] Lidhur me pretendimet e ngritura ne ankese, KSHA arsyeton si me poshte:

• *Për kerkesën e pare, per pretendimin ne lidhje me kriterin e vendosur nga AK:*

Tek shtojca 8, kriteret e pergjithshme te perzjedhjes/kualifikimit, pika 2.3.2 AK ka kerkuar:

Operatori ekonomik duhet te jete distributor zyrtar per territorin e Republikes se Shiperise per marken e pajisjes ge posedon/ ose te jete i paisur me autorizimin nga distributori zyrtar vendas per kryerjen e sherbimit objekt prokurimi. Ne rastin e autorizimit nga distributore zyrtar vendas, duhet te paragitet lidhja midis prodhuesit he distributorit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme per ak ne rast verifikimi nga ana e tij.

KSHA, i ngritur nga AK me urdhrin nr. 3208/4, date 08.06.2023, "Për pezullimin e procedurave dheshqyrtimin e ankeses per tenderin me objekt: "Sistem i Menaxhuart i Printimit (SMP)», me REF-70915-05-30-2023, e merr ne konsiderate kerkesen e OE Infosoft Office.

Per sa me siper, pretendimi i ankuesit per kerkesen e pare, qëndron.

Per kerkesen e dyte, per pretendimin ne lidhje me modifikimin e kriterit te vendosur nga AK:

Tek shtoja 8, kriteret e pergjithshme te perzjedhjes/kualifikimit, pika 2.3.4 kerkohet qe:

Operatori ekonomik duhet te kete te punësuar staf teknik te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose distributori i autorizuar per mirembajtjen e pajisjeve që oferton, ose certifikuar nga institucionet e autorizuar te akredituara nga dpa ose nga organizma ndërkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqipërisë.

• KSHA, konstaton se OE Infosoft Office kerkon qe ky kriter te modifikohet si me poshte:

“Operatori ekonomik duhet te kete te punësuar staf teknik te pakten 2 inxhinier (Elektronik/, Mekanik/IT/Mekatronik ose Teknik te certifikuar nga institucionet e autorizuar te akredituara nga DPA ose nga Organizma ndërkombëtare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqipërisë”

Persa i përket kerkeses për modifikim nga ana e OE, si me siper, KSHA gijkon se kjo kerkese eshte ne kundërshtim te plotë me vendimin nr. 6/2023, date 06.01.2023, te KPP, pika III.1.8 ku përcaktohet se:

*..ne lidhje me pretendimet per ndryshimin e kriterit:

OE duhet te kete jo me pak se 5 punonjës ne liste pagese nga te cilët 3 nga keta punonjes te jene teknike elektronike te pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik te lëshuar nga organet perkatese. Per keta punonjes duhet te paragiten deshmitë perkatese de duhet qe te figuronjnë liste pagesat e 3 muajve te fundit, gjykon, se kriteri i vendosur nuk eshte ne perpjesëtim dhe i lidhur ngushte me objektin e kontrates, pasi autoriteti kontraktor ne rastin konkret ku objekt është “Shërbim printimi” e rendesishme është kryerja e shërbimit. Ne këtë kontekst kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor jo me pak se 5 punonjës ne liste pagese, nga te cilët 3 punonjës te jene te diplomuar si inxhinier Elektronik/mekatronik ose IT eshte një kriter i cili e kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike ne nje procedure prokurimi si dhe ul konkurrencen, dhe jo ne proporcion me objektin e kesaj procedure prokurimi, nuk është e nevojshme nje ekspertize e tille, pasi dhe punonjes me kualifikime te ndryshme mund te kryejne te njejtën detyre, ndaj autoriteti kontraktor duhet te modifikojë kriterin e ne funksion te hapjes se konkurrences ndërmjet operatoreve ekonomike duke mos kufizuar ate me togfjalëshin "Inxhinier". Pra, nisur nga arsyetimi i KPP ne vendimin nr. 6/2023, date 06.01.2023, pika III.1.8, perdorimi i togfjalëshit "inxhinier" si pjese e kriterit do ishte ne dem te hapjes së konkurrences dhe biznesit të vogël dhe te mesëm, pasi vendosja e stafit te diplomuar "Inxhinier" do te pengonte se pari bizneset e vogla e e mesme, të cilat mund te kene staf teknik, por jo te diplomuar si “Inxhinier”. KSHA konstaton se togfjalëshin “Teknik të certifikuar nga institucionet e autorizuar nga DPA ose nga Organizma nderkombëtare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise” Autoriteti Kontraktor e ka përfshire ne kriterin 2.3.4, “Operatori ekonomik duhet te ketë te punësuar staf teknik te pakten 2 (dy) punonjës te certifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose distributori i autorizuar per mirëmbajtjen e pajisjeve që oferton, ose certifikuar nga institucionet e autorizuar te akredituara nga DPA ose nga Organizma Nderkombëtare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqipërisë”

- *KSHA vlerëson se Sistemi i Menaxhuar i Printimit, objekt i këtij prokurimi do të realizohet me 50 pajisje të cilat do të sillen nga OE fitues. Në këtë kriter është kërkuar nga OE që, përveç implementimit të pajisjeve, do të mirëmbajnë, riparojnë, furnizojnë me pjesë konsumi pajisjet që do të perdoren në këtë proces. Që të realizohet shërbimi i kërkuar, i gjithë sistemi duhet të monitorohet dhe të gjitha pajisjet të jenë në gjendje pune 100% të kohës. Është minimum dhe thelbësore për mirëfunksionimin e të gjithë procesit nevojat e specialistëve të trajnuar për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Defektet janë të pashmangshme dhe këtu lind nevojat e një specialisti të trajnuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre.*

- *KSHA gjykon se, nënse nga volumi i kontratës, kriteri ku kërkohej që OE të ketë minimalisht dy punonjës të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve është në proporcion të drejtë me volumin dhe natyrën e kontratës.*

KSHA gjykon se, ky kriter është vendosur për të hapur procedurën ku të marrin pjesë biznese të vogla dhe të mesme të cilat nuk mund të sigurojnë një certifikatë trainimi për pajisjet që posedojnë ngaproduhësi i pajisjespor që ka mundësi ta sigurojnë nëpërmjet organizmave të akredituar apo subjekteve të licencuara.

KSHA vlerëson se, AK është në të drejtën e tij të sigurohet për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE, të cilat, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, ekonomike, makinerite, pajisjet he asetatet e tjera fizike, përvijën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

- *KSHA vlerëson se ky kriter është vendosur në harmoni të plotë dhe i mbështetur dhe nga vendimi i KPP Nr. 1280/2022, datë 22.12.2022, pikë III.2.8, e arsyetimit, ku shprehet se: Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Autoriteti Kontraktore në hartimin e kriterëve dhe /ose specifikimit teknike, krahas përshkrimit të saktë të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i tyre duhet të bëhet në mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshem dhe të hapur nëpërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmeri të kontratës. KPP thekson se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë OE pjesëmarrës në procedurat e Prokurimit Publik. Kriteret e vendosura dhe/ose specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pa justifikuar për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimit teknike AK duhet të shmangin do formë diskriminimi goftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast kriteret dhe/ose specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik.*

..akoma me tej AK është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësia e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. RPP vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë AK për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE të cilat nëpërmjet dokumenteve të paraqitura duhet të vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisje dhe asetatet e tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvijën e duhur si dhe

personelin e nevojshem gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates është ne te drejtën e AK te përcaktoje kriteret per kualifikim ne perputhje me dispozitat ligjore kur ato jane te nevojshme dhe te lidhura ngushte me objektin e prokurimit.

Komisioni vlerëson se bazuar ne kompleksitetin dhe volumin e kontrates objekt prokurimi, kërkesa per disponimin e një inxhinieri te certifikuar nuk eshte kërkesë e ekzagjëruar por e certifikuar nga prodhuesi eshte kerkesë kufizuese dhe me synim nxitjen e konkurrencës dhe sigurimin e nje trajtimi te barabarte dhe jo diskriminues per te gjithë operatorët ekonomik pjesmarrësne procedurat e prokurimit prandaj AK duhet të marre masa per modifikimin e ketij kriteri duke vendosur dhe togfjalëshin certifikime dhe ekuivalente.

• KSHA konstaton se kriterin “Për te pasur staf teknik te certifikuar per mirembajtjen e pajisjeve” Komisioni i Prokurimit Publik e ka mbështetur dhe me vendimin nr.06/2023, datë 06.01.2023, pika III.3.3 ku shprehet Komisioni konsideron kriter minimal te cilat nuk do te rendonin pozitat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës ne këto procedure.”

KSHA vlerëson se AK ka patur parasysh që punonjësit e certifikuar për mirembajtjen e pajisjes që posedone te jenë jo vetëm nga prodhuesi i pajisjeve por dhe nga Distributore te Autorizuar (me te drejtën per te dhene certifikata trajnimi) apo dhe nga institucionet e autorizuar te akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombetare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqipërisë.

Per sa me siper, pretendimi i ankuesit per kerkesën e dyte, nuk qëndron.

• Për kerkesen e trete, per pretendimin n° lidhje me specifikimet e pajisjeve, te vendosura nga AK: a. Nje specifikim jashte listes se AKSHI-t, eshte: “”ekrani jo me i vogel se 8 inch”.

• KSHA vlerëson se ne lidhje me diapazonin e ekranit AK, mbeshtetur dhe ne vendime te meparshme te KPP (vendimi 970/2021, date 07.12.2021) ka pasur ne konsiderate që diapazoni i ekranit te kenç nje madhesi mesatare (jo me te vogël se 8 inch), kriter ky jo diskriminues ne vendosjen e specifikimeve teknike, pasi nuk @shte diapazoni me i madh i ekranit. Te gjitha brandet e pajisjeve, te paktën te 3 viteve te fundit, per shkak te teknologjise se re (e cila ka prekur dhe kete fushete pajisjeve te IT), jane te pajisura me ekran deri ne 10.1 inch, tek te gjitha formatet e pajisjeve, si për formatet A4, po ashtu dhe tek formatet A3/A4. Sa me siper, AK ka zgjedhur diapazon mesatar te ekranit si kriter minimal (8 inch), pa penguar ge pajisjet te vijne dhe me ekran 8.5; 9; 9.5 apo 10.1. Na teknologjine e re te viteve të fundit të pajisjeve te printimit, ekрани nuk ka me vetem nje rol informues ku shfaqen vetem komandat e leximit (print/copy; ready or not) por te gjitha komandat e pajisjes, perfshi komandat e numrave, ikonat e ndryshme të funksionit te pajisjes deri tek ikonat e teknologjise se re, te cilat, sipas AK nuk mund te vendosen to gjitha ne nje ekran 4.3 inch (aplication site, conection, copy, print, scan, user guide, user tools, ëeb broëse, quick user, quick card, quick scanner, quick print, print/scan (memory storage device) apo te githe informacionin mbi funksionalitetin e parisjes mbi perdorimin e saj apo dhe statusin e saj ne kohe reale. AK ne vendosien e Ketin kriteri ka patur parasysh faktin se komandat ne rast fotokopjimi te dokumenteve nuk mund te funksionone ne nje ekran me prekje ne madhësine 4.3 inch ku duhet te shfagen te gjithë numrat, si dhe do te cenonte rendë funksionalitetin e pajisjes.

Teknologjia e re ne ditet e sotme nuk eshte komoditet, por është nevojë e perditshme per te na sherbyer dhe lehtësuar ndjeshëm ne punt e perditshme te nje punonjësi apo te institucionit/kompanise ne ditët e sotme.

- KSHA vlerëson se AK ka arsye te qenësishme per te ofruar këte teknologji, e cila ofrohet nga te gjitha kompanite dhe brandet ne treg, per te krijuar kushte optimale per punonjësit e vet ne përdorimin e saj dhe duke ekonomizuar kohën ne përdorimin e pajisjeve.*

KSHA vlerëson se AK në vendosjen e specifikimeve për pajisjet që do të ofrohen nga OE per sistemin e menaxhimit te printimit ka patur parasysh perfshirjen e te gjithë operatorët ne treg si dhe te gjitha brandet e pajisjeve.

- KSHA konstaton se OE Infosoft Office kerkon se një seri specifikimesh që jane vendosur tek pajisjet qe do te merren ne perdorim nga AK kanë shmangie nga vendimit nr 673, dt. 22.11.2017” standardet dhe jane ne kundertshim me standartet TIK te miratuara nga AKSHI, sipas vendimit 673 dt.22.11.2017.*

Sipas pikes nenit 6, pika j, te VKM nr. 673, dt. 22. 11.2017, AKSHI Jep mendim per institucionet e tjera te administrates publike, me kerkese te tyre, per: - specifikimet teknike te prokurimeve, që do të realizohen me fonde të buxhetit të shtetit, hua dhe/ose grante te dhëna nga donatore,

- KSHA vlereson se procedura e prokurimit ka objekt "Sistemi i menaxhimit te printimit" per nevojat e shoqërisë "Albpetrol" sha, dhe pajisjet nuk do te blihen por do te vihen ne perdorim ose me qira nga operatorët ekonomike.*

Qëllimi i VKM nr 673, dt. 22.11.2017, eshte sugjerimi per blerjet per pajisjet TIK, me specifikime minimale, që do te blihen nga institucione publike, te cilat kanë pasur veshtirësi për nxjerrjen e specikimeve minimale he te cmimeve te tyre per blerje per perllogaritjen e fondit limit.

Per këtë AKSHI, sipas specifikime te paraqitura, ka ndertuar dhe tabelën udhëzuese me listen e çmimeve te blerjeve, te cilat institucionet publike mund tu referohen per blerjen e tyre.

Por AKSHI nuk ndalon qe te blihen pajisje me performance me te larte dhe te perditësuar me teknologjine e ditës (dhe aq me tepër pajisje te cilat do te merren me qira ose ne perdorim) nga ana e AK, për te patur garanci ne realizimin me sukses te kontrates dhe per lehtësi ne funksionalitet dhe ne përdorim.

Per sa me siper, pretendimi i ankuesit për kërkesën e trete, lidhur me specifikimin e pajisjeve me "ekrani jo me i vogël se 8 inch", nuk qëndron.

- Për kërkesen e trete, per pretendimin ne lidhje me specifikimet e pajisjeve, te vendosura nga AK:*

b. skanimi nepermjet SD CARD.

- KSHA konstaton se OE Infosoft Office nuk eshte dakord me specifikimin teknik ge skanimi te kryhet dhe me SD card pasi, sipas OE, këte specifikim e përmbush vetëm një marke e caktuar pajisjesh ose nje numer shume i kufizuar pajisjesh.*

- KSHA konstaton se Vendimi nr. 970/2021, i Komisionit te Prokurimit Publik, date 7.12.2021, pika III.2.6 e arsyetimit, percakton se. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se per realizimin e sherbimit te skanimit mund te përdoren disa alternativa sic eshte percaktuar ne specifikimet teknike, gjithashtu autoriteti kontraktor mund të vendose dhe variantin e perdorimit te adaptorit, i cili mund te kryeje shërbimin e kërkuar per pajisjet per printim/fotokopjim/skaner, duke mundësuar perdorimin e SD CARD-it.*

KSHA, mbështetur ne vendimin nr. 970/2021 te KPP, date 7. 12.2021, vendos ta pranoje pretendimin e OE Inforsoft Office dhe te modifikojë specifikimin ne kriterin e vendosur, si me poshte ndryshoje:

Ishte:

Skanimi: SPDF-single pas document

Full Netëork color Scan (Scan to e-mail,

feeder (skanimi i njehershem te dy aneve scan to folder, Scan to USB, SD CARD) te letres)

Behet:

Skanimi: SPDF-single pas document Full Netëork color Scan (Scan to e-mail, feeder (skanimi i njehershem te dy aneve scan to folder, Scan to USB, SD CARD) te letres)

skanimi me SD CARD te kryhet dhe me adaptor

Për sa me sipër, pretendimi i ankuesit per kerkesën e trete, lidhur me specifikimin e pajisjeve "skanimi nepermjet SD CARD", qendron.

Për këto arsye:

Bazuar ne nenin 114 te ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 102 te vendimit nr. 285, te Keshillit te Ministrave, date 19.05.2021, "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", KSHA.

VENDOSI:

1. Te pranojë pjeserisht ankesen e paraqitur nga OE Inforsoft Office, përkatësisht:

a. Te pranoje ankesen ne lidhje me heqjen e kriterit 2.3.2, ne shtojcën 8, "Kriteret e Pergjithshme te Perzjedhjes/Kualifikimit",

b. Te mos pranoje ankesen ne lidhje me modifikimin e kriterit pika 2.3.4, në shtojcën 8, "Kriteret e Pergjithshme te Perzjedhjes/Kualifikimit";

c. Te mos pranoje ankesen ne lidhje me modifikimin e kriterit "specifikimi i pajisieve - "ekrani jo me i vogël se 8 inch";

d. Te pranojë ankesen ne lidhje me modifikimin e kriterit "specifikimi i pajisjeve - "skanimi nepermjet SD CARD», sipas arsyesimit ne kete vendim.*

2. Ky vendim i komunikohet Titullarit te AK, shogëria "Albpetrol" sh.a.

3. Kopje e këtij vendimi i njoftohet OE ankimes dhe Komisionit te Prokurimit Publik.

[...].

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i cili parashikon shprehimisht se : Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” ShPK, se: “[...]Tek Shtojca 8, Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 2.3.4 kërkohet që:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose distributori i autorizuar për mirembajtjen e pajisjeve që oferton, ose certifikuar nga institucionet e autorizuar të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Autoriteti Kontraktor e argumenton nevojën e pikës 2.3.4 si me poshtë:

Argumentimi: : Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik dhe nenit 41, pika 4 g”ërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë aftësinë teknike dhe kanë staf të specializuar të inxhinierëve dhe specialistëve të brigadës së remontit për realizimin me sukses të kontratës së shërbimit me autosondë dhe këto kritere janë në përputhje të plotë dhe proporcionale lidhur me kontratën objekt prokurimi.

Perseri, si OE I interesuar për të marrë pjesë, verejme një kufizim të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik të ndryshëm nepermjet kriterit të certifikimit të pakten të 2 teknikeve nga ana e prodhuesit të pajisjes apo distributorit të autorizuar. Ky kriter është si pika 2.3.2 është jo proporcional me objektin e kontratës si dhe permaset e saj. Në total I gjithë shërbimi I-vjecar I kerkuar perfshin 50 pajisje nepermjet të cilave do të printohen 920,000 kopje.

Ne mbështetje të argumenteve të dhëna me lart bazohemi dhe në Vendimin Numer 06/2023 të Komisionit të Prokurimit Publik I cilifoz I jep të drejte OE Rikon-Al për heqjen e certifikimeve të prodhuesit dhe distributorit të autorizuar për pajisjet që disponon AK (Lexmark, Xerox).

Ne mbështetje të këtij argumenti qendron vendimi Numer 412/2022 ku Komisioni I Prokurimit Publik i jep të drejte OE Infosoft Office për heqjen e kriterit Stafit teknik të (pakten 3 inxhinierë)

duhet të jetë i certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve që posedon për mirembajtjen e pajisjeve ose ekuivalente.

Per kete arsye kerkojme modifikimin e kriterit si me poshte ne:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik të paktën 2 inxhinierë (Elektronik/Mekanik/IT/Mekatronik, ose Teknik të certifikuar nga institucionet e autorizuara të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.4. “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.4. *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose distributori i autorizuar për mirembajtjen e pajisjeve që oferton, ose certifikuar nga institucionet e autorizuara të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Për këtë të paraqiten:

- *Certifikata përkatëse për mirembajtjen e pajisjeve që oferton.*
- *Listepagesat e shoqërisë për të pakten tre muajt e fundit në të cilat specialistet e siperpermendur duhet të figurojë.*

Shënim: *Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.*

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

III.2.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.3. Neni 3 “Parime të përgjithshme i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues 6 për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të

padrejtë operatorë ekonomike të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.4 Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon: 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.2.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. 8 Autoritetet ose entet kontraktore, në

veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.6. Neni 41, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.7. Në nenin 4 “Përkufizime” të ligjit Nr.162/2020 Për Prokurimin Publik, parashikohet se: “Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlershme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit.

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së mësipërme të lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike/kriterëve. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Kriteret e vendosura dhe/ose specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike autoritet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast kriteret dhe/ose specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbim që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. K.P.P gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë lex specialis parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se kriteret dhe/ose specifikimet

teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 dhe 77 të LPP. Akoma me tej, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkalar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Në rastin konkret, Komisioni konstaton, se referuar ankesës së operatorit ekonomik, si dhe nga shqyrtimi i termave të referencës dhe specifikimet teknike, Komisioni gjykon, se bazuar në kompleksitetin dhe volumin e kontratës objekt-prokurimi, kërkesa për disponimin e n “2 (dy) punonjës të certifikuar”, nuk është një kërkesë e ekzagjeruar, por “certifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose distributori i autorizuar” është kërkesë kufizuese dhe me synim nxitjen e konkurrencës dhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri, duke vendosur togfjalëshin “Ekuivalente” për certifikime ekuivalente.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” ShPK, se: “[...]4. Tek DST, Shtojca 5, Ankesi 1 jepen specifikimet teknike te pajisjeve:

<i>Fotokopje/Printer/Skaner</i>	
<i>Teknologjia</i>	<i>Lazer/Bardh/zi</i>
<i>Shpejtesia jo me e vogel se:</i>	<i>25 faqe/min</i>
<i>Ekrani jo me i vogel se:</i>	<i>8 inch</i>
<i>Resolucioni</i>	<i>1200x1200 dpi</i>
<i>Dimensioni W x D x H , jo me imadh se:</i>	<i>350x495x505</i>
<i>Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:</i>	<i>300 faqe</i>
<i>Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:</i>	<i>100 faqe</i>

<i>Madhesia e letres</i>	<i>A6-A3</i>
<i>Memorja jo me e vogel se:</i>	<i>1 GB</i>
<i>HDD - Hardisk jo me i vogel se:</i>	<i>250 GB</i>
<i>Aplikacione</i>	<i>Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.</i>
<i>Connection</i>	<i>Ethernet, USB</i>
<i>Mundesi skanimi ne HDD</i>	<i>Pajisja duhet te mundesoj skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues</i>
<i>Skanimi: ARDF</i>	<i>Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, USB, SD Card)</i>
<i>Shpejtesia e Skanimit</i>	<i>30 ipm</i>
<i>Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)</i>	<i>Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria</i>
<i>Secure printing</i>	<i>Pajisja duhet te mundesoj encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.</i>
<i>Printimin ne te dyja anet (Duplex)</i>	<i>Po</i>
<i>Pajisja te mundesoj skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.</i>	

10 pajisje -A4 me shpejtesi te mesme me keto specifikime:

<i>Fotokopje/Printer/Skaner</i>	
<i>Teknologjia</i>	<i>Lazer/Bardh/zi</i>
<i>Shpejtesia jo me e vogel se:</i>	<i>25 faqe/min</i>
<i>Ekrani jo me i vogel se:</i>	<i>8 inch</i>
<i>Resolucioni</i>	<i>1200x1200 dpi</i>
<i>Dimensioni W x D x H , jo me imadh se:</i>	<i>480x445x510</i>

<i>Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:</i>	<i>300 faqe</i>
<i>Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:</i>	<i>200 faqe</i>
<i>Madhesia e letres</i>	<i>A6-A4</i>
<i>Memorja jo me i Vogel:</i>	<i>1 - 2 GB</i>
<i>HDD - Hardisk jo me i vogel se:</i>	<i>250 GB</i>
<i>Aplikacione</i>	<i>Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.</i>
<i>Connection</i>	<i>Ethernet, USB</i>
<i>Mundesi skanimi ne HDD</i>	<i>Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues</i>
<i>Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)</i>	<i>Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)</i>
<i>Shpejtesia e skanimit</i>	<i>40 ipm (simplex) / 80 ipm(duplex)</i>
<i>Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)</i>	<i>Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria</i>
<i>Secure printing</i>	<i>Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.</i>
<i>Printimin ne te dyja anet (Duplex)</i>	<i>Po</i>
<i>Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.</i>	

30 pajisje me ngjyra-A4 me keto specifikime

<i>Fotokopje/Printer/Skaner</i>	
<i>Teknologjia</i>	<i>Lazer/me ngjyra</i>
<i>Shpejtesia jo me e vogel se:</i>	<i>25 faqe/min</i>

<i>Ekrani jo me i vogel se:</i>	<i>8 inch</i>
<i>Resolucioni</i>	<i>1200x1200 dpi</i>
<i>Dimensioni W x D x H , jo me imadh se:</i>	<i>500x585x510</i>
<i>Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:</i>	<i>200 faqe</i>
<i>Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:</i>	<i>150 faqe</i>
<i>Madhesia e letres</i>	<i>A6-A4</i>
<i>Memorja jo me e vogel se:</i>	<i>1 GB</i>
<i>HDD - Hardisk jo me i vogel se:</i>	<i>250 GB</i>
<i>Aplikacione</i>	<i>Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.</i>
<i>Connection</i>	<i>Ethernet, USB</i>
<i>Mundesi skanimi ne HDD</i>	<i>Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues</i>
<i>Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)</i>	<i>Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)</i>
<i>Shpejtesia e skanimit</i>	<i>40 ipm (simplex) / 80 ipm (duplex)</i>
<i>Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)</i>	<i>Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria</i>
<i>Secure printing</i>	<i>Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.</i>
<i>Printimin ne te dyja anet (Duplex)</i>	<i>Po</i>
<i>Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.</i>	

2 pajisje me ngjyra-A4/A3 me keto specifikime

<i>Fotokopje/Printer/Skaner</i>	
<i>Teknologjia</i>	<i>Lazer/me ngjyra</i>
<i>Shpejtesia jo me e vogel se:</i>	<i>25 faqe/min</i>
<i>Ekrani jo me i vogel se:</i>	<i>8 inch</i>
<i>Resolucioni</i>	<i>1200x1200 dpi</i>
<i>Dimensioni W x D x H , jo me imadh se:</i>	<i>590x685x1210</i>
<i>Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:</i>	<i>800 faqe</i>
<i>Kapaciteti ne dalje jo me e vogel se:</i>	<i>300 faqe</i>
<i>Madhesia e letres</i>	<i>A6-A3</i>
<i>Memorja jo me e vogel se:</i>	<i>1 GB</i>
<i>HDD - Hardisk jo me i vogel se:</i>	<i>200 GB</i>
<i>Aplikacione</i>	<i>Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.</i>
<i>Connection</i>	<i>Ethernet, USB</i>
<i>Mundesi skanimi ne HDD</i>	<i>Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues</i>
<i>Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)</i>	<i>Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)</i>
<i>Shpejtesia e skanimit</i>	<i>110 ipm (simplex)/ 180 ipm (duplex)</i>
<i>Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)</i>	<i>Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria</i>
<i>Secure printing</i>	<i>Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te</i>

	<i>printim/skanim/fotokopjim.</i>
<i>Printimin ne te dyja anet (Duplex)</i>	<i>Po</i>
<i>Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.</i>	

- a. *Nje specifikim jashte listes se AKSHI-t, eshte: ekrani jo me i vogel se 8 inch. Ky standart nuk perfshihet fare ne standartet e miratuara nga AKSHI pasi nuk eshte nje specifikim teknik qe ka te beje me punen apo cilesine e printimit/fotokopjimit apo skanimit. Shtrojme pyetjen se cfare funksioni kryen ekrani i pajisjes? Ekrani i pajisjes ka funksion thjesht informues dhe nuk ndikon fare ne funksionalitetin e paisjes. Kete funksion, e kryen cfaredolloj ekrani, duke filluar nga 4.3inch, qe eshte standarti normal per keto paisje. Si argument mbi specifikimin e ekranit mbi 8 inch AK mund ta lidhe edhe me komoditetin e punonjesve. Komoditeti nuk perfshihet ne asnje nga vendimet e AKSH-it, vendime te cilat perditesohen cdo vit. AK duhet te argumentojte nevojat lidhur me funksionalitetin dhe jo ithjesht per komoditetin Sipas LPP, kriteret e vendosura duhen argumentuar nga ana funksionale. Nuk parashikohet askund argumenti mbi komoditetin e punonjesve per perdorimin e pajisjeve. Komandat e parashikuar ne ekranet 8 inch mund te gjenden lehtesisht dhe ne ekranet me te vogla si 4.3 Inch etj. Per kete arsye kerkojme rishikimin e diapozonit te ekranit te pajisjes nga 8 inch ne 4.3 inch. b. Gjithashtu kerkohet skanimi nepermjet SD Card. Skanimi me SD CARD eshte nje specifikim qe e permbush vetem nje marke e caktuar pajisje, ose nje numer shume i kufizuar markash. Nderkohe qe jane kerkuar dhe menyra ekuivalente skanimi si: Scan to email, scan to folder, Scan to USB. Vendosja e kerkeses per skanim me SD CARD eshte vetem nje pengese per ofertim dhe kufizon pjesmarrjen e ofertuesve, pasi eshte kerkese qe permbushet vetem nga nje numer i limituar markash. Qellimi kryesor i LPP eshte te krijojte mundesi per ofertim per sa me shume OE. Vendosja e kufizimeve te tilla eshte shkelje e parimit themelor te LPP dhe si e tille kerkojme qe te hiqet si detyrim skanimi me SD Card per te gjitha modelet e printerave te kerkuar Ne mbeshtetjeve te 2 kerkesave tona me lart qendron dhe Vendimi I KPP Nr. 412/2022 si dhe Vendimi Nr. 321/2023. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” autoriteti kontraktor ka parashikuar specifikimet teknike për artikujt:

ANEKSI 1 – Nevojat dhe specifikimet e pajisjeve të SMP

3 pajisje -A4/A3 me shpjetesesi te mesme me keto specifikime :

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi

Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	8 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H , jo me i madh se:	590x675x965
Kapaciteti mbajtes i syrtareve, jo me i vogel se:	800 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	300 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja jo me e vogel se:	1 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, USB, SD Card)
Shpejtesia e Skaimit SPDF :	120 ipm (simplex) / 240 ipm (duplex)
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

5 pajisje -A4/3 me shpejtesi te mesme me keto specifikime :

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min

Ekrani jo me i vogel se:	8 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H , jo me imadh se:	350x495x505
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	300 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	100 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja jo me e vogel se:	1 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoj skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: ARDF	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, USB, SD Card)
Shpejtesia e Skanimit	30 ipm
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoj encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoj skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

10 pajisje -A4 me shpejtesi te mesme me keto specifikime:

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/Bardh/zi
Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min

Ekrani jo me i vogel se:	8 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H , jo me imadh se:	480x445x510
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	300 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	200 faqe
Madhesia e letres	A6-A4
Memorja jo me i Vogel:	1 - 2 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoj skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)
Shpejtesia e skanimit	40 ipm (simplex) / 80 ipm(duplex)
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoj encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoj skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

30 pajisje me ngjyra-A4 me keto specifikime

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/me ngjyra
Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min

Ekrani jo me i vogel se:	8 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H , jo me imadh se:	500x585x510
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	200 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me i vogel se:	150 faqe
Madhesia e letres	A6-A4
Memorja jo me e vogel se:	1 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	250 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)
Shpejtesia e skanimit	40 ipm (simplex) / 80 ipm (duplex)
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print, Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

2 pajisje me ngjyra-A4/A3 me keto specifkime

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Lazer/me ngjyra

Shpejtesia jo me e vogel se:	25 faqe/min
Ekrani jo me i vogel se:	8 inch
Resolucioni	1200x1200 dpi
Dimensioni W x D x H , jo me imadh se:	590x685x1210
Kapaciteti mbajtes i syrtareve jo me i vogel se:	800 faqe
Kapaciteti ne dalje jo me e vogel se:	300 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja jo me e vogel se:	1 GB
HDD - Hardisk jo me i vogel se:	200 GB
Aplikacione	Pajisja duhet te mundesoj instalimin e aplikacioneve te ndryshme, duke perfshire dhe aplikacion per monitorim apo menaxhim printimi.
Connection	Ethernet, USB
Mundesi skanimi ne HDD	Pajisja duhet te mundesoje skanimin ne HDD e saj dhe krijimin e folderave te ndryshem per secilin perdorues
Skanimi: SPDF-single pas document feeder (skanimi i njehershem te dy aneve te letres)	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to USB, SD CARD)
Shpejtesia e skanimit	110 ipm (simplex) / 180 ipm (duplex)
Mobile printing(aftesi printimi nga celulari)	Apple AirPrint, Google Cloud Print,Mopria
Secure printing	Pajisja duhet te mundesoje encryptimin te hardiskut per ruajtjen e informacionit te printim/skanim/fotokopjim.
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po
Pajisja te mundesoje skanimin e dokumentave direct ne Dropbox, Sharepoint, icloud, etc.	

Kërkesa të përgjithshme për sistemin

- Pajisjet do të instalohen në ambientet e zyrave të administratës së “Albeptrol” sha sipas planvendosjes së tyre paraqitur në skicat e planimetrive për çdo kat të godinave.

- Pajisjet do të instalohen në rrjetin kompjuterik LAN të zyrave të “Albpetrol” sha të integruara me sistemet e tjera të menaxhimit të informacionit duke ofruar fleksibilitet të plotë për printimin, skanimin, fotokopjimin dhe shpërndarjen (fax, e-mail, shared folder) të dokumenteve.
- Pajisjet duhet të implementohen brenda 30 ditësh nga firmosja e kontratës.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët ose broshurat për mallin që oferton.

ANEKSI 2 - Kërkesat për kontrollin dhe monitorimin e SMP

Në mënyrë që Sistemi i Printimit të Menaxhuar të jetë i kontrollueshëm dhe monitorueshëm, si lidhur me menaxhimin proaktiv të pajisjeve, ashtu edhe me mbikëqyrjen për utilizimin dhe përdorimin e tyre, është e nevojshme që ky Sistem të monitorohet nëpërmjet aplikimeve Software që duhet të mundësojnë:

- Monitorimin i statusit të pajisjeve në kohe reale duke përdorur protokollet SNMP 1/2/3
- Menaxhimin dhe konfigurimin e pajisjeve në mënyrë të centralizuar. Krijimin e profileve të ndryshme të printimit, skanimit me anë të software dhe shpërndarjen e konfigurimit të të gjithë pajisjet, një grup apo disa pajisje në mënyrë automatike.
- Printim me element sigurie (duke venë kodin personal ose kartë) në secilën prej pajisjeve në rrjet.
- Raportimin me email për sasine e printimeve të secilit përdorues (nëse aplikohet), të gjithë paisjeve apo një grupi të tyre.
- Menaxhimin e pajisjeve me përdorues dhe konfigurimet përkatëse në mënyrë të centralizuar.
- Ruajtja e raporteve në server në mënyrë periodike (ditore, javore, mujore, vjetore).
- Dërgimi i emaileve automatike në rast të shfaqjes së problemeve teknike.
- Dërgimi i emaileve automatike që tregon statusin e tonerit dhe lajmërimi për ndërrimin e tij në menyre proaktive.
- Krijimi i raporteve për sasinë e printimeve, fotokopjimeve, skanimeve për secilin përdorues, sektor, drejtori etj.
- Software-i duhet të ruajë në databazë të gjithë aktivitetin e pajisjes dhe të mundësojë krijimin e raporteve mbi bazë pajisjesh apo grupi pajisjesh. Krijimin e raporteve për kohën që pajisjet kanë ndenjur pa punë për arsye të problemeve teknike, krijimin e raporteve për kohën e shfaqjes dhe zgjidhjes së një problemi teknik dhe shpjegimin e natyrës së problemit të shfaqur.
- Mundësimi për upgrade automatik me anë të software-ve të versioneve të fundit të firmwareve të pajisjeve.
- I gjithë sistemi duhet të jetë automatik dhe të monitorohet nga një qendër e vetme.

Kërkesa të përgjithshme për sistemin

- Sistemi duhet të ofrojë mundësi për monitorimin e gjendjes fizike, konsumimit dhe nevojës për një shërbim proaktiv të pajisjeve të angazhuara në SMP;
- Sistemi duhet të ofrojë mundësi për menaxhimin e tij në funksion të mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi shkallën e utilizimit dhe mënyrën e përdorimit të pajisjeve si dhe mbi optimizimin shpërndarjes së pajisjeve në përputhje me nevojat që do të paraqiten;
- Sistemi duhet të përfshijë edhe ato aplikime apo programe që facilitojnë shpërndarjen e dokumenteve që përpunohen nëpërmjet fax, e-mail apo skedarëve të përbashkët në server-at e “Albpetrol” sha;
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët ose broshurat për aplikimet dhe softwarët.

- Instalimi dhe konfigurimi i këtyre aplikimeve duhet të mbështetet me trajnimin e përdoruesve për funksionet bazë si dhe trajnimin e stafit teknik që do të bëjë administrimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e sistemit.
- Konfigurimi i sistemit duhet të kryhet brenda 30 ditësh nga data e nënshkrimit të kontratës dhe të jetë funksional përgjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës.
- Sistemi duhet të mundesoje konfigurime të ndryshme mbi pajisjet në mënyrë të centralizuar. Krijimin e një konfigurimi dhe dërgimin e tij në të gjitha pajisjet e tjera në mënyrë automatike.
- Sistemi duhet të mundesoje update për “firmware” të pajisjeve në mënyrë të centralizuar pa patur nevojën të behen një nga një dhe në mënyrë manuale.

Monitorimi i sistemit

Nga përdorimi i software mund të analizohet çdo operacion i printimit dhe monitorohet volumi i printimit për çdo përdorues, ekziston mundësia e përditësimit të software nga versioni aktual në versionin e ardhshëm të platformës software-ike.

Siguria -në aspektin e sigurisë software duhet të menaxhoje karakteristikat e mëposhtme:

- Mbrojtja kundër përdorimit të paautorizuar të printimit;
- Ndarjen dhe administrimin e të drejtave të printimit për përdoruesit e ndryshëm, rolet apo departamentet.
- Vështrim i menjëhershëm se kush është duke shtypur, çfarë dokumenti dhe në cilën pajisje.

Monitorimi dhe Raportimi - në drejtim të monitorimit dhe raportimit software duhet të trajtojë specifikat e mëposhtme:

- Monitorimin e saktë për gjithë printimet, kopjimin dhe skanimin;
- Një raport standard, të lehtë për t’u lexuar me përmbledhje të bazuar në përdoruesit, sektorët, drejtoritë dhe projektet;
- Mundësinë për të krijuar raporte specifike duke ju përshtatur nevojave të ndryshme;
- Raporte automatike që mund të gjenerohen nga IT administratori dhe dërgohen në e- mail ose dosje në formatin e zgjedhur (html, xls, xml, CSV, PDF).

Menaxhimi i Printimit - në aspektin e menaxhimit të sistemit të printimit, sistemi duhet të ofrojë përfitimet e mëposhtme:

- Menaxhimin e shërbimit të printimit sipas kërkesave të institucionit, duke aktivizuar “rules&routing” për shërbimin mbi baze përdoruesi, departamenti apo institucioni.
- Printimin, duke ju ofruar web faqes, me mundësi për të shtuar dhe fshirë printime të ndryshme;
- Printimin në shumë lloje pajisjesh (follow me printing), duke i dhënë mundësi përdoruesit që puna e tij të mos ngeçë në asnjë moment.
- Mundësi për vendosjen e kuotave të printimit për secilin përdorues.
- Të mundesoje lajmërimin e përdoruesve nëse arrihet apo tejkalohet kuota nga përdoruesi.

Menaxhimi i Skanimit - në aspektin e menaxhimit të sistemit të skanimit, sistemi duhet të ofrojë përfitimet e mëposhtme:

- Skanimin automatik me një klik të vetëm për përdoruesit dhe dërgimin e dosjes/ dokumentit në folder/e-mail;
- Përpunimin e dokumentit pas skanimit;
- Mundësinë e krijimit të një dokumenti të vetëm me shumë fletë të skanuara.

Në përgjithësi - sistemi duhet të mundësojë optimizimin në mënyra të ndryshme të trajtuara edhe më poshtë:

- Monitorimin e të shërbimeve të printimit në kuadër të kompanise, nëpërmjet një web-faqe të vetme.
- Centralizimin e mënyrave dhe karakteristikave të printimit;
- Optimizimin e funksionimit të rrjetit;
- Ofrimin e shërbimeve të printimit nga të gjitha vendet edhe në rast të dështimit të serverit qëndror.

ANEKSI 3 - Kërkesat dhe kushtet për furnizimin dhe shërbimet ndaj Sistemit

Në këtë Aneks përfshihen termat dhe kushtet e ofrimit të shërbimeve që do të kryen për furnizimin e pajisjeve me materiale konsumi (bojë, toner, pjesë ndërrimi), për pastrimin dhe mirëmbajtjen periodike të tyre, riparimin e pajisjeve që mund të paraqesin defekte si dhe zëvendësimin e përkohshëm të pajisjeve difektoze me një pajisje të ngjashme duke mos shkaktuar ndërprerjen e punës së punonjësve.

Pjesë e kontratës që do të angazhohet midis “Albperol” sha dhe operatorit ekonomik të përzgjedhur do të jetë edhe Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit e cila do të mbulojë të gjithë kohëzgjatjen 1 vjeçare të kontratës.

III.3.2. Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;
ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.3.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit.. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj". Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 "Për prokurimin publik" KE, parashikohet se: "*Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim*". Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "*specifikim teknik*" nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një

specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

III.3.4. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit si dhe ka detyrë të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike, të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë, për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues kundërshton specifikimin teknik për diapazonin e ekranit të pajisjeve (Ekranin e pajisjes) 8 inch në 4.3 inch. Për sa i përket ekranit të pajisjes, përmasa e vendosur 8 inch nuk ndikon aspak në funksionalitetin apo performancën e pajisjes të mësipërme, duke kufizuar ndjeshëm konkurrencën. Referuar këtij specifikimi teknik, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kjo e fundit nuk lidhet me funksionalitetin në tërësi të pajisjes apo në kryerjen e shërbimit të kërkuar dhe të cilësisë së tij. Madhësia e ekranit nuk pengon mirëfunksionimin e pajisjeve edhe realizimin e shërbimit të ofruar në kohë dhe me cilësi, ndaj Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson që autoriteti kontraktor duhet të ndryshojë parametrat e ekranit, duke përcaktuar një diapazon minimumi dhe

maksimumi të përmasave të ekranit për pajisjet e kërkuara, duke mos kufizuar në mënyrë të panevojshme konkurrencën, pasi përjashton ata operatorë ekonomikë që ofertojnë artikujt e mësipërm me specifikime të ndryshme, po me cilësitë funksionale të kërkuara.

Kërkesa e operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-70915-05-30-2023, me objekt “Sistem i menaxhuar i printimit (SMP)” me fond limit 5,870,000 (pesë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol Sh.A.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar
Fiovent Zguro	Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

